



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për mediumet-

Shkup, 16.06.2021

Kushte jo të unifikuara për menaxhimin e transferimeve kapitale tek komnatat nga Buxheti i RMV-së

Dokumentet strategjike për ndërtimin e qëllimeve, politikave dhe aktiviteteve afatgjata për një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e transferimeve kapitale në nivel shtetëror, NUK kanë gjithmonë qëllime dhe aktivitete të qarta, tregues të përcaktuar dhe burime të financimit. Gjithashtu, mos miratimi i metodologjisë për mënyrën e shpërndarjes së fondeve për transferimet kapitale, NUK mundëson menaxhimin e integruar të tyre.

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizion të suksesit me temë **"Transferet e kapitalit tek NJVL-të nga Buxheti i RMV-së"**, në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020, në mënyrë që t'i përgjigjet pyetjes: **A ka një sistem efektiv për menaxhimin e transferimeve kapitale tek NJVL-të nga Buxheti i RMV-së?**


Revizioni i suksesit përfshiu periudhën kohore të viteve 2017-2019, por fusha të caktuara, çështje dhe ngjarje janë mbuluar edhe para vitit 2017 dhe më pas deri në datën e njoftimit për revizionin e kryer.

Me revizionin e kryer, në fushën e **kushteve normative për menaxhimin e transferimeve kapitale**, revizorët konkluduan se legjislacioni nuk përshkruan një mënyrë të unifikuar të veprimit të përdoruesve buxhetor për menaxhimin e dotacioneve kapitale. Respektivisht, Qeveria e RMV-së që nga viti 2004 ka detyrimin të miratojë Dekretin për metodologjinë për shpërndarjen e dotacioneve kapitale, e cila ende nuk është miratuar. Kjo gjendje çon në veprime të ndryshme nga ana e përdoruesve buxhetor, gjë që nuk mundëson menaxhimin e integruar të dotacioneve kapitale, dhe njëkohësisht ndërlikon monitorimin e tyre dhe mundësinë e një pasqyre të qartë dhe të plotë të gjendjes.

Revizorët përcaktuan se në mungesë të informacionit mbi dotacionet kapitale në qarkoren buxhetore, dhe duke pasur parasysh afatin dhe mënyrën e miratimit të

Programeve Vjetore dhe Vendimeve për zbatimin e tyre, komunat nuk janë në gjendje të planifikojnë realisht të hyrat dhe shpenzimet nga dotacionet kapitale. Dallimet më të mëdha midis shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara janë në pjesën e shpenzimeve kapitale. Në **vitin 2017**, ato janë realizuar në vlerë **prej 40%** të shpenzimeve të planifikuara kapitale, **në 2018** përqindja është **41%**, ndërsa **në vitin 2019** realizimi i tyre është **60%**.

Me revizionin e kryer u arrit në përfundimin se në periudhën 2017-2019 nga Buxheti i RMV-së tek NJVL-të për investime kapitale në infrastrukturë dhe përmirësimin e mjedisit jetësor u transferuan rreth 3 miliardë denarë. Pjesëmarrja ndaj secilit përdorues buxhetor në fondet totale të transferuara për investime kapitale në NJVL paraqitet në grafikun vijues.



Në raportin e revizionit theksohet se investimet kapitale zakonisht përfshijnë ndërtimin e objekteve të infrastrukturës, realizimi i të cilave kërkon një periudhë më të gjatë kohore, marrja e një vendimi për financimin e tyre në mes të vitit aktual, krijon rrezik për realizimin e plotë dhe në kohë të fondeve të siguruara nga buxheti për vitin aktual për atë qëllim.

Në periudhën lëndë e revizionit, nga Qeveria e RMV-së janë transferuar mjete në vlerë prej **896 milion denarë** për investime kapitale tek NJVL-të, nga të cilat shumica ose **643 milion denarë** janë transferuar si mjete **për zvogëlimin e ndotjes së ajrit**, posaçërisht në komunat me përqindja më e lartë të ndotjes së ajrit. Gjithashtu, Qeveria transferoi fonde në vlerë prej **140 milion denarë** për **pastrimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në komunën e Tetovës**.

Gjithashtu, revizorët konstatuan se përmes **Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural**, në periudhën 2017-2019, janë realizuar gjithsej **776 milion**

denarë për investime kapitale në komuna . Mjetet janë paguar për financimin e gjithsej ***162 projekteve tek 65 komuna***, nga të cilat ***36 janë komuna urbane*** dhe për to janë transferuar ***448 milion denarë***, ndërsa ***29 janë komuna rurale*** për të cilat janë paguar ***328 milion denarë***.

Analiza e të dhënave tregon se shumica e fondeve jepen për nënmasat ***për përmisimin e cilësisë së jetës në zonat rurale***.

Me revizionin u konkludua se edhe përkundër detyrimeve ligjore, përdoruesit buxhetor nëpërmjet të cilëve zbatohen programet me masat për dotacionet kapitale, nuk dorëzojnë informacione të plota Qeverisë së RMV-së për realizimin e aktiviteteve. Gjendja e tillë bën që Qeveria e RMV-së të mos ketë të mos ketë një pasqyrë të plotë të fondeve totale të transferuara, si dhe për shkallën e realizimit dhe efektet e investimeve kapitale, e cila nga ana tjetër ndikon në vendimet kombëtare për shpërndarjen efikase të fondeve për projektet e investimeve kapitale në periudhat e ardhshme.

Linku deri tek raporti:

[https://dzt.mk/sites/default/files/2021-](https://dzt.mk/sites/default/files/2021-06/44_RU_Kapitalni_transferi_kon_ELS_od_Budzetot_na_RSM_2020_KOMPLET_REDUCE.pdf)

[06/44_RU_Kapitalni_transferi_kon_ELS_od_Budzetot_na_RSM_2020_KOMPLET_REDUCE.pdf](https://dzt.mk/sites/default/files/2021-06/44_RU_Kapitalni_transferi_kon_ELS_od_Budzetot_na_RSM_2020_KOMPLET_REDUCE.pdf)

Press kontakt:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72 228 203

albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijalçe Durgutov +389 70 358 486

mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517

martin.duvnjak@dzt.gov.mk